



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-69
Prishtinë, më 16 qershor 2009, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 16 QERSHOR 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Myfera Shinik dhe Slllobodan Petroviq, anëtarë të Kryesisë së Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Lulzim Zeneli dhe Xhezair Murati.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Naim Abazi, Shaban Selimi dhe Shefqet Rexhepi.

Nga OSBE-ja, Petrit Hysaj.

Nga NDI-ja, Avni Zuka.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe për pikat shtesë që do të procedohen sipas radhës.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 9 qershor 2009,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare më 23 qershor 2009,
3. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare më 25 qershor 2009,
4. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave,
5. Të ndryshme.

1. Miratimi Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 9 qershor 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 9 qershor 2009, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare më 23 qershor 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e ministrit të Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, lidhur me kërkesën për mundësinë e mbajtjes të seancës plenare, para datës 25 qershor 2009, vendosi që të mbahet një seancë e veçantë më **23 qershor 2009**, në të cilën do të debatohet lidhur me informatën e ministrit të Punëve të Brendshme të datës 25 prill për incidentin në Dhomën e Provave në Policinë e Kosovës.

3. Propozimi i rendit të ditës për seancën e plenare më 25 qershor 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që seanca e ardhshme e Kuvendit të mbahet më 25 qershor 2009, me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lizingun financiar,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore,
7. Rishqyrtimi i Ligjit për të drejtat sendore,
8. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit për Ndhimë Juridike,
9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2008, dhe

10. Shqyrtimi i propozim vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e zëvendës-drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë së Pronës dhe të dy anëtarëve të Bordit të kësaj agjencie.

4. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave

4.1 Shqyrtimi i kërkesës së disa deputetëve për të debatuar në seancën e radhës për gjendjen në Radio Televizionin e Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur me lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkesa e disa deputetëve për të debatuar në seancë plenare për gjendjen në Radio Televizionin e Kosovës, do të procedohet në pajtim me rregullën 6.5 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, gjegjësisht do të radhitet në seancën plenare të Kuvendit brenda tri (3) javë pune.

4.2 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Zafir Berisha, përkrahur edhe nga disa deputetë të Kuvendit, për shpalljen e Prizrenit kryeqytet i Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur me lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Në bazë të nenit 13 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kryeqyteti i Republikës së Kosovës është Prishtina.
2. Ndryshimi i selisë së kryeqytetit të Kosovës, mund të bëhet vetëm mbi bazën e procedurave të parapara për ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

5. Të ndryshme

5.1 Njoftimi me rekomandimin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion dërguar Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me funksionimin e bordeve të agjencive të pavarura.

Kryetari njoftoi Kryesinë e Kuvendit me rekomandimin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, dërguar Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me funksionimin e bordeve të agjencive të pavarura.

5.2 Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e zëvendës drejtorit të Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë së Pronave dhe dy anëtarëve të Bordit të kësaj agjencie

Kryesia propozimin e Qeverisë e ka radhitur në rend dite për seancën plenare më 25 qershor 2009.

5.3 Shqyrtimi i propozim vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e cekur me lart, mori këtë

V E N D I M

Miratohet në parim *propozim*-vendimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me pagat .

5.4 Shqyrtimi i propozimit të deputetit Naim Maloku për mos kontrollin nëpërmjet skanerit(detektuesit elektronik) të anëtarëve të Kryesisë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e cekur me lart, mori këtë

V E N D I M

1. Anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk i nënshtrohen kontrollit – kalimit nëpërmjet skanerit (detektuesit elektronik) në hyrje të ndërtesës së Kuvendit.
2. Ngarkohet sekretari i Kuvendit që të koordinojë zbatimin e këtij vendimi me Shërbimin e Sigurimit të ndërtesës së Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**